



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:014388  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05874455

KPPP.nr.472/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Gjorgjievi” dooel, me adresë në rrugën “Industriska bb” Nr.2420, Republika e Maqedonisë së Veriut, me NRB: 6184022, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra e avokatisë “B & BH” Sh.P.K., me seli në Gjilan, me avokat Burim Islami, kundër debitorit NPT “RAKITA” me seli në Ferizaj, me adresë në rrugën “Driton Islami” p.n, me NRB: 80009364, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.245/20 të datës 30.12.2020, nga Përmbartuesi Privat Përparim Xhelili me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 25.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit NPT “RAKITA” me seli në Ferizaj, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.245/20 i datës 30.12.2020, i Përmbartuesit Privat Përparim Xhelili, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit nga i autorizuari i kreditorit “Gjorgjievi” dooel, me datë 30.12.2020, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.245/20, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme dhe atë: Faturës nr.2020/009 të datës 03.06.2020, Faturës nr.2019/35 të datës 15.10.2019, Faturës nr.2019/27 të datës 08.07.2019, dhe Faturës nr.2018/29 të datës 02.10.2018, me të cilin e ka obliguar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit obligimin në shumën e mbetur të papaguar në lartësinë prej 34,833.43 Euro, si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaresit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të procedurave të LPP-së, sipas nenit 40 par.1 nën.par.3, me arsyetimin se propozimi për përmbarim është dorëzuar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, ngase dispozita e lartcekur parasheh se propozimi duhet të përmbaj mes tjerash edhe origjinalin apo kopjet e vërtetuara. Më tej debitori ka theksuar se ka pranuar vetëm propozimin dhe asnjë provë tjetër, qoftë faturat apo autorizimin e dhënë nga kreditori, dhe se në propozim citohen faturat por që asnjëra nga to nuk janë dorëzuar, në mënyrë që vet debitori të mund ta bëjë krahasimin nga libri i tij i kontabilitetit për ta parë krahasimin se a janë bërë këto pagesa. Ka shtuar se debitori nuk ka asnjë lloj obligimi ndaj kreditorit, dhe se të gjitha faturat janë të paguara. I ka propozuar gjykatës që urdhrin përmbarimor ta hudh poshtë, ose të caktoj seancë që të bëhet ballafaqimi mes të dyja palëve.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se kreditori ka paraqitur propozimin për përmbarim bazuar në dokumentin e besueshëm-faturave të cekura si në propozim, të përcjellura edhe me dëshminë mbi dërgesat ndërkombëtare për çdo dërgesë të përkthyer në gjuhën shqipe, dhe të bashkangjitura si provë në kopje të vërtetuara pranë Noterit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, konform LPP-së. Më tej ka theksuar se në rastin konkret, faturat paraqesin dokument përmbarimor, pasi kemi të bëjmë me dokumente të lëshuara në procedurë administrative, respektivisht me CMR të cilat përmbajnë të dhënat e dërguesit dhe marrësit, si dhe të dhënat e transportuesit i cili e ka bërë transportin e mallit i cili është objekt i faturave dhe shumën e obligimit e cila është e njejtë me shumën e shënuar në fatura, pra nuk ka dilemë që malli është dërguar dhe ka kaluar në doganë për të arritur te debitori NTP “Rakita”. Ka shtuar se propozimi për përmbarim ka të evidentuar të gjitha numrat e faturave, datën e tyre, shumën e obligimit, dhe në çdo faturë është i shënuar edhe numri i

kamionit me të cilin është realizuar transporti nga kreditori tek debitori. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat, si dhe të obligohet debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 416 Euro, sipas TOAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura nr.2020/009 e datës 03.06.2020, Fatura nr.2019/35 e datës 15.10.2019, Fatura nr.2019/27 e datës 08.07.2019, Fatura nr.2018/29 e datës 02.10.2018, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat e lartcekura janë dorëzuar te debitori pasi që të njëjtat nuk janë nënshkruar ose vulosur nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbarim.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga faturat.

Gjykata, në rastin konkret po ashtu vlerësoi edhe CMR-të, si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave, të cilat janë të nënshkruara dhe vulosura nga kreditori,

mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga faturat. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.472/24, datë 25.06.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.